



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
REKTORI

Nr. 639 / prot. 5

Elbasan, më 27.03.2026

URDHËR

Nr. 47 / 2 . datë 27.03.2026

"PËR SHPALLJEN E KANDIDATIT FITUES"

Në mbështetje të Ligjit nr.80/2005, datë 22.07.2005 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë; Udhëzimit nr. 27 datë 29.02.2007 "Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet publike të arsimit të lartë"; Vendimit nr. 17 datë 20.03.2025 "Për miratimin e numrit të punonjësve, strukturës organizative dhe nivelit të pagave për çdo pozicion pune në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" i Bordit të Administrimit të UE-së; Statutit dhe Rregullores së Organizimit dhe Funksionimit të Universitetit të Elbasanit "A. Xhuvani" të ndryshuar; pika 3 e nenit 20 të Vendimit nr. 70 datë 17.11.2025 "Për miratimin e rregullores për plotësimin e vendeve të lira të punës të kategorisë personel ndihmësakademik në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", të Senatit Akademik,

SHPALL

Zj. Marsela Balla, fituese, në pozicionin e punës, personel ndihmësakademik me karakter administrativ, me kohë të plotë, specialist statistike i nivelit të mesëm në zbatim, në Drejtorinë e Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, në Rektorat, pas zhvillimit të procedurave të konkurrimit të brendshëm.

Ky Urdhër të publikohet menjëherë, në faqen zyrtare elektronike të Institucionit.

REKTORI

Prof.dr. Elvira Fetahu

